




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.05.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 438, të datës 06.05.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, në lidhje me propozimin e Shoqatës 'Miq të Amerikës' Nr. 158, të datës 07.03.2016, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin e Komuniteteve, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 dhe nenin 27, shkronja (g), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shpalljen post-mortem "Qytetar Nderi", i komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2016


1. Z. Robert Finlayson 'Robin Cook', i lindur më 28 Shkurt 1946 në Bellshillt të Skocisë, është arsimuar në Aberdeen Grammar School, ka studiuar dhe diplomuar në Fakultetin e Letërsisë Angleze në Universitetin e Edinburgut, punoi si mësimdhënës. Ishte organizator i mirë dhe udhëheqës i Shoqatës Arsimore të Punëtorëve për Lothian dhe këshilltar lokal në Edinburg, parlamentar, sekretar për tregti e industri, sekretar për shëndetësi dhe shërbime sociale, sekretar për punë të jashtme, anëtar i Partisë së Punës dhe Kryetar i Partisë së Socialistëve Evropian, shpallet post-mortem "Qytetar Nderi", i komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2016.
2. Z. Robert Finlayson 'Robin Cook', në pozitën e Sekretarit për Punë të Jashtme në Foreign in Office e Britanisë së Madhe, ka dhënë kontributin e tij për mbrojtjen dhe avancimin e kërkesave të popullit të Kosovës për pavarësi, liri dhe demokraci.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Zyrës së Presidentit të Kosovës, Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, Zyrës së Kryeparlamentarit të Kosovës, Zyrës së Ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës, Ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë, Zyrës së Presidentit Bill Clinton në Nju Jork, Shoqatës 'Miq të Amerikës', Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr. sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.06.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2016, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 435, të datës 13.05.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar për tremujorin e parë të vitit 2016 në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për tremujorin e parë të vitit 2016, në shumë të përgjithshme prej 1,266,482.01€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër kategoritë ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Për rroga dhe paga buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 1,090,559.23€;
 - 2.2 Për mallra dhe shërbime buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 61,802.16€;
 - 2.3 Për shpenzime të komunalive buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 10,129.18€;
 - 2.4 Për subvencione dhe transfere buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 33,993.85€ dhe
 - 2.5 Për pasuri jofinanciare buxheti i shpenzuar është në shumë të mjeteve financiare prej 69,997.59€
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa dhe Buxhet.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr. scj Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Numër/Br. sh. 82
Datë/Date 06.06.2016
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 06.06.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2016 pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 428, të datës 12.05.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 7 dhe Nenin 27, shkronja (g), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për nderim me titullin “Nderi i Qytetit” i Komunës së Fushë-Kosovës për znj. Shahe Sinani

1. Për nderimin me titullin “Nderi i Qytetit”, të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2016, znj. Shahe Sinani, e lindur më 18 Mars 1959 në fshatin Dobrajë të Komunës së Lipjanit, me vendbanim në Komunën e Fushë-Kosovës, për humanizmin e treguar për strehimin dhe mbajtjen e fëmijës me aftësi të kufizuara.
2. Znj. Shahe Sinani, me strehimin e fëmijës me aftësi të kufizuara ka dhënë kontributin e saj dhe ka treguar humanizëm për mirëqenien e fëmijës.
3. E lartëcekura gëzon privilegjet e parapara për titullin “Nderi i Qytetit” e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së SHMS, znj. Shahe Sinani dhe Arkivës.**

